

DRAFT - PROJEKT MARRËVESHJA E BASHKIMIT ME PËRTHITHJE

Sot, në datën 23/10/2023 hartohet kjo Marrëveshje e Bashkimit midis palëve të mëposhtme:

- **ANTEA CEMENT SH.A.** një shoqëri e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, me seli "Rruga e Durrësit", Pallati mbrapa Ring Center, Zona Kadastrale 8210, pasuria 3/8, Tiranë, Shqipëri me NIPT K61914005R përfaqësuar nga administratori i saj Z.Mario Bracci (në vijim referuar si "Antea" ose "Shoqëria Përthithëse");
- **ALBA CEMENTO SH.P.K.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit me numër NIPT K01610001T, me seli Tiranë, Katund i Ri, Autostrada Tiranë-Durrës, Shqipëri, përfaqësuar nga administratori i saj Julian Brati (në vijim referuar si "Shoqëria e Përthithur" ose "Alba")

Antea dhe Alba referohen më poshtë individualisht si "Pala" dhe së bashku "Palët", ose "Kompanitë subjekt i bashkimit".

MEQENESE:

- A. Antea është ortak i vetëm i cili zotëron 100% të kapitalit të Alba Cemento shpk.
- B. Antea, si ortak e vetme e Alba Cemento shpk vlerësoi paraprakisht mundësitë e ndryshme për racionalizimin e pjesëmarrjeve të saj në kapitalin e shoqërive të kontrolluara, duke marrë në konsideratë qëndrueshmërinë aktuale dhe në të ardhmen, natyrën e biznesit, si dhe rentabilitetin e aktivitetit të biznesit të Palëve. Pas vlerësimit, Antea vendosi që të dyja kompanitë të bashkohen dhe rrjedhimisht, Alba Cemento shpk do të bashkohet me Antean dhe do të përthithet nga kjo e fundit duke bërë që Antea të jetë i vetmi subjekt juridik pas përfundimit të bashkimit.
- C. Alba Cemento shpk do të përthithet nga Antea, sipas kushteve të përcaktuara në këtë projekt marrëveshje për bashkimin dhe në përputhje të plotë me ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë.
- D. Kapitali i regjistruar dhe struktura e kapitalit të Anteas nuk do të ndryshojë pas bashkimit, prandaj kjo Marrëveshje dhe ky bashkim nuk do të përfshijë dispozitat mbi raportin e këmbimit të aksioneve/kuotave, shumën e çdo pagese në mjete monetare ose kushtet e ndarjes së aksioneve/kuotave në Kompaninë Përthithëse.
- E. Në zbatim të Nenit 225, paragrafi 2 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Palët përjashtohen nga detyrimi për të hartuar dhe paraqitur raportin e hollësishëm (detyrim i cili lind nga Neni 216 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare) si dhe nga detyrimi për caktimin e ekspertit (detyrim i cili lind nga Neni 217 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare).



Silvana Dervishi
PERKTHYESE



PALETË NË KËTË PROJEKTMARRËVESHJE BIEN DAKORD SA MË POSHTË:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

1.1. Në këtë Marrëveshje, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e shpjeguara si më poshtë:

“Aktivet dhe Detyrimet e Transferueshme”	janë të gjitha aktivet dhe detyrimet që transferohen nga Alba Cemento shpk (Kompania e Përthithur) tek Antea (Kompania Përthithese), sikundër përshkruhet në këtë Marrëveshje në pikën 4.1.
“Bashkim”	është Bashkimi me Përthithje i Alba Cemento shpk nga Antea.
“Ligji për Shoqëritë Tregtare”	është ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
“Kodi i Punës”	është Ligji nr 7961, datë 12.07.1995 “Mbi Kodin e Punës”, i ndryshuar;
“Marrëveshje”	është kjo Projekt Marrëveshje e Bashkimit me Përthithje – duke përfshirë, si pjesë përbërëse të saj, deklaratat e mësipërme dhe shtojcat bashkëlidhur, të cilat janë nënshkruar dhe shkëmbyer nga dhe midis Palëve;

1.2. Në Këtë Marrëveshje:

- 1.2.1. Çdo statut ose dispozitë staturore i referohet statutit ose dispozitës staturore të ndryshuara, modifikuara ose ri-miratuara ose të dyja herë pas here (qoftë para ose pas datës së kësaj Marrëveshje) dhe çdo legjislacion tjetër të parashikuar sipas statutit ose dispozitës staturore (qoftë para ose pas datës së kësaj Marrëveshje).
- 1.2.2. Një klauzolë ose shoqë, përveç se kur parashikohet ndryshe nga konteksti, i referohet një klauzole ose shtojce të kësaj Marrëveshje.
- 1.2.3. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga konteksti, numri njëjës do të përfshijë numrin shumës dhe anasjelltas, për më tepër:
 - 1.2.3.1. Një gjini do të përfshijë gjininë tjetër.
 - 1.2.3.2. Ora e ditës është ora në Tiranë, Shqipëri.
 - 1.2.3.3. Titujt e kësaj Marrëveshje të Bashkimit nuk do të çënojnë interpretimin ose kuptimin.
 - 1.2.3.4. Shtojcat janë pjesë e kësaj Marrëveshje dhe rrjedhimisht janë efektive.

2. BASHKIM ME PËRTHITHJE

- 2.1. Sipas termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshje, Alba Cemento shpk do të përthithet nga Antea.
- 2.2. Në zbatim të nenit 220 dhe nenit 225 të Ligjit për Shoqëritë, Alba Cemento shpk do të transferojë tek Antea nëpërmjet bashkimit, tërësisht të gjitha aktivet dhe detyrimet e saj dhe ekzistenca më vete e Alba Cemento shpk do të përfundojë. Antea, si Kompania Përthithëse, do të vazhdojë ekzistencën e saj si kompani nën emrin e saj: ANTEA CEMENT SH.A;

3. EFEKTIVITETI KONTABËL

- 3.1. Tërësia e aktiveve dhe detyrimeve të Alba Cemento shpk, të cilat do të transferohen tek Antea, do të bazohen në bilancin e audituar të Alba Cemento shpk të vitit financiar të mbyllur me 31 dhjetor 2022.
- 3.2. Antea do të aplikojë opsionin për konsolidimin retrospektiv, prandaj bilanci i parë pas bashkimit do të paraqitet si rezultat i inkorporimit të njëkohshëm të bilancit dhe gjendjes së pasqyrës së të ardhurave të Alba Cemento shpk tek Antea duke filluar nga data 1 janar 2024.

4. VIJUESHMERIA DHE AKTIVET E TRANSFERUARA

- 4.1. Data Efektive e bashkimit dhe e lindjes së pasojave dhe efekteve juridike të parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare si dhe nga kjo Marrëveshje, do të jete data kur QKB pranon dhe miraton përfundimisht procedurat e bashkimit me përthithje të dy Shoqerive pale në këtë Marrëveshje, në përputhje me Nenin 220 paragrafi (3) (“Data Efektive e Bashkimit” ose “Data Efektive”).
- 4.2. Duke filluar nga Data Efektive, Antea do të jetë pasardhësja, nëpërmjet bashkimit me përthithje, e Alba Cemento shpk në çdo dhe të gjitha kontratat, aktet dhe marrëdhëniet kontraktore dhe financiare në të cilat Alba Cemento shpk është palë, qoftë ekzistuese ose në të ardhmen.

Silvana Dervishi
PËRTHITHËSE

- 4.3. Rrjedhimisht, nga Data e Efektive, siç përcaktohet edhe në këtë Nen 4, të gjitha veprimet, aktivet dhe detyrimet, duke përfshirë të gjitha aktivet materiale dhe jomateriale, aktivet financare (përfshi, mjetet monetare, të gjitha tepricat kreditore dhe investimet në letra me vlerë), si dhe të gjitha pronat e paluajtshme, marrëdhëniet kontraktuale dhe marrëdhëniet e tjera juridike dhe pozicione juridike e çfarëdo lloji, të arkëtueshme dhe detyrime, detyrimet potenciale dhe të ardhurat e ardhshme dhe të kushtëzuara të Alba Cemento shpk, do të transferohen tek Antea dhe do të konsiderohen dhe trajtohen si të Anteas. (“Aktivet dhe Detyrimet e Transferuara”).
- 4.4. Aktivitetet dhe detyrimet që do të transferohen do të përfshijnë në mënyrë të vecantë, por nuk do të kufizohen në sa më poshtë vijon (respektivisht nëse gjejnë zbatim):
- i. Çdo dhe të gjitha aktivet dhe të drejtat mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, aktivet materiale dhe jomateriale, pa asnjë kufizim ose përjashtim, të cilat i përkasin ose do t'i përkasin Alba Cemento shpk;
 - ii. Të gjitha markat tregtare, modelet e dizajnit, patentat, njohuritë, ekspertizën dhe të drejtat e tjera intelektuale të Alba Cemento shpk;
 - iii. Liçensa, koncesione, autorizimin dhe të drejtat të ngjashme të Alba Cemento shpk;
 - iv. Bazën e klientëve të Alba Cemento shpk;
 - v. Çdo kontratë qiraje, sigurimi, furnizimi, konsultimi, kontrata shërbimi dhe kontrata në të cilat Alba Cemento shpk është palë, qoftë të lidhura tashmë ose që janë aktualisht në proces negociimi;
 - vi. Çdo kredi të dhënë, borxh të marrë, depozitë të çdo lloji të krijuar nga Alba Cemento shpk;
 - vii. Çdo dhe të gjitha të drejtat që lidhen me ndonjë dhe të gjitha detyrimet e vendosura nga Alba Cemento shpk;
 - viii. Çdo kërkesë, mosmarrëveshje, padi dhe procedurë kundrejt çdo Autoriteti ku Alba Cemento shpk është palë;
 - ix. Çdo dhe të gjitha detyrimet që i atribuohen Alba Cemento shpk, duke përfshirë detyrimet potenciale (angazhimet) dhe detyrimet e ardhshme të Alba Cemento shpk, të cilat kanë ndodhur tashmë.
- 4.5. Antea do të marrë në zotërim të gjithë librat, korrespondencën, të dhënat operative dhe të dhënat e tjera të biznesit që ruan dhe mban Alba Cemento shpk.
- 4.6. Antea gjithashtu do të marrë në zotërim çdo dhe të gjitha instrumentet dhe dokumentet e nevojshme të paraqitur të drejtat që i janë transferuar asaj. Antea do të ruajë librat, korrespondencën, të dhënat operative dhe të dhënat e tjera të biznesit të Alba Cemento shpk përgjatë gjithë periudhës ligjore të ruajtjes.
- 4.7. Të gjitha regjistrimet, shënimet, titujt dhe/ose shënimet në lidhje me Alba Cemento shpk në Zyrën e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme, Regjistrin e Barrës Siguruese, ose ndonjë regjistër tjetër që mbahen nga çdo Autoritet do të transferohen Anteas në Datën e Efektive nëpërmjet bashkimit me përthithje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Antea do të jetë pasuesi i Alba Cemento shpk në çdo dhe të gjithë të drejtat, kompetencat dhe marrëdhëniet që kanë të bëjnë me Alba Cemento shpk dhe që rrjedhin nga dispozitat e aktet ligjore dhe / ose nënligjore. Çdo dhe të gjitha barrat, hipotekat, kolaterale ekzistuese dhe / ose garancitë e krijuara në favor të Alba Cemento shpk, dhe nga Alba Cemento shpk në favor të palëve të treta, do të vazhdojnë të jenë të vlefshme, në favor të Anteas si pasardhëse e Alba Cemento shpk dhe të zbatueshme sipas klasifikimit të tyre.

5. ZOTERIMI I AKSIONEVE DHE KAPITALI

5.1 Shoqëria Përthithëse do të vazhdojë të ketë të njëjtin aksioner që zotëron kapitalin e Shoqërisë Përthithëse dhe asnjë vlerë në lidhje me vlerën nominale të aksioneve si dhe numrin e tyre nuk do të pësojë ndryshim;

5.2 Të drejtat dhe detyrimet e aksionerëve të Shoqërisë Përthithëse nuk do të pësojnë ndryshime dhe do të jenë të njëjta në përputhje me dispozitat e Statutit në fuqi;

5.3 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë Përthithëse nuk do të pësojë ndryshim si rezultat i bashkimit.

6. KUSHTET PËR REALIZIMIN E MBYLLJES SE BASHKIMIT

6.1. Përfundimi i transaksionit të bashkimit të parashikuar në bazë të kësaj Marrëveshje është subjekt dhe kushtëzohet nga plotësimi dhe përbushja e kushteve të mëposhtme përpara Datës Efektive:

Silvana Dervishi
PËRKTHYESE

- i. Vendimi i Asamblesë së Ortakëve (Ortakut të Vetëm) i Alba Cemento shpk i cili miraton përfundimisht Marrëveshjen duhet të jetë i miratuar të paktën një muaj pas datës së publikimit të projektit të kësaj Marrëveshje në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me nenet 216, 220 dhe 225 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

7. EFEKTET E BASHKIMIT

Nga Data Efektive:

- 7.1. Kuota e Alba Cemento shpk do të konsiderohet e anuluar;
- 7.2. Çdo aksion i Anteas do të vazhdojë të jetë aksion i Anteas me të njëjtën vlerë nominale dhe i zotëruar nga i njëjti aksioner;
- 7.3. Nuk ekziston asnjë titullar i obligacioneve të konvertueshme dhe aksioneve preferenciale që preken nga Bashkimi. Nuk jepet asnjë e drejtë e posaçme.
- 7.4. Administratori i Shoqërisë së Përthithur do të konsiderohet i shkarkuar. Ndërkohë organet administruese (administrator, këshill mbikëqyrës) i Shoqërisë Përthithëse nuk pësojnë ndryshime.
- 7.5. Adresa e Shoqërisë Përthithëse nuk do të pësojë ndryshim dhe do të mbetet e njëjta.

8. MBROJTJA E KREDITORIT

- 8.1. Kreditorët e Alba Cemento shpk janë të mbrojtur në zbatim të nenit 221 të Ligjit për Shoqëritë.

9. PASOJAT PËR PUNONJËSIT

- 10.1 Në Datën e Efektive, të gjitha kontratat e punës ku Alba Cemento shpk është pjesëmarrëse si palë në atë kohë, do të transferohen në bazë të ligjit tek Antea, e cila do të vazhdojë kontratën e punës të punonjësve të transferuar së bashku me të gjithë të drejtat dhe detyrimet.
- 10.2 Kontratat kolektive të Alba Cemento shpk, nëse ka, do të zëvendësohen nga kontrata kolektive të Anteas;
- 10.3 Antea do të jetë përgjegjëse për çdo dhe të gjitha detyrimet, përfshi detyrimet e papaguara që burojnë nga kontratat e transferuara të punës.

10. PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES

- 10.1. Kjo Marrëveshje do të përfundojë vetëm në bazë të miratimit me shkrim të Palëve përpara Datës Efektive.

11. LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- 11.1. Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në të gjitha aspektet në përputhje me ligjet dhe çdo dokument tjetër që ka forcën e ligjit në Republikën e Shqipërisë.
- 11.2. Juridiksioni kompetent do të jetë Gjykata e Tiranës.

12. TË NDRYSHME

- 12.1. *Ndryshimet e Marrëveshjes*
Ndryshimet e kësaj Marrëveshje bëhen efektive vetëm nëse janë bërë me shkrim nga Palët.
- 12.2. *Gjuha*
Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe.
- 12.3. *Kostot*
Antea do të paguaje kosotot në lidhje me Bashkimin dhe në vecanti kosotot që lidhen me Mbylljen dhe përgatitjen e të gjithë dokumentacionit ligjërish të detyrueshëm.
- 12.4. *Paraqitja e kërkesave*
Palët bien dakord që Antea dhe Alba Cemento shpk do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme brenda kompetencave të tyre, që duhen për të siguruar dhe garantuar përmbushjen e kushteve të parashikuara në Marrëveshje. Palët do të përmbushin të gjitha detyrat sipas Nenit 225 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare e cila parashikon rastet e veçanta të bashkimit me përthithje kur Shoqëria Përthithëse është zotëruesi i plotë i kapitalit të Shoqërisë së Përthithur. Gjithashtu do të zbatohen të gjitha procedurat e nenit 220 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare në përputhje me hapat e parashikuara në rastet e veçanta të Nenit 220.

Silvana Dervishi
PERKTHYESE


Për të shmangur çdo dyshim, paraqitja e kërkesës në Qendrën Kombëtare të Biznesit do të bëhet nga të dyja Palët në këtë Marrëveshje.

KY DOKUMENT PËRBËN NJË PROJEKT-MARRËVESHJE MIDIS PALËVE DHE NËNSHKRIMI I MËPOSHTËM NGA PËRFAQËSUESIT LIGJOR TË SECILËS PALË VËRTETON QË KY DRAFT ËSHTË DRAFTI I DAKORDËSUAR MIDIS PALËVE PËR T'U NËNSHKRUAR, MIRATUAR DHE DEPOZITUAR SIPAS AFATEVE TË NENIT 216, NENIT 220 DHE NENIT 225 TË LIGJIT PËR SHOQËRITË TREGTARE. NËNSHKRIMI I MËPOSHTËM NGA PALËT NUK PËRBËN HYRJE NË FUQI TË DRAFT- MARRËVESHJES.

Pasi përkthyesja zyrtare Silvana Dervishi dha asistencën në përkthimin e kësaj Projekt -Marrëveshje në gjuhën angleze, Palët deklaruan se e kuptuan, dhe e gjetën atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë, dhe e nënshkruan atë rregullisht.

PËR ANTEA CEMENT SHA


Z. Mario Bracci
Administrator



PËR ALBA CEMENTO SHPK


Z. Julian Brati
Administrator




Silvana Dervishi
PËRKTHYESE